


TË FALIM SA MË SHUMË



DASHURI NË DEMOKRACI

INSTITUCIONI MË I LARTË DEMOKRATIK

RREZARTA (12), FJONA (12), ARNISA (13), ELSA (12), DONART (13), ENES (13), ANDI (12)



Këtu kemi paraqitur Kuvendin e Kosovës dhe disa fakte rreth tij

Të lumtur që sot jemi gazetarë, ju ftojme ta lexoni artikullin tonë. Flet për Kuvendin dhe rëndësinë e tij

Të gjithë ne meritojmë të jemi të lumtur dhe të ndihemi të vlefshëm dhe të sigurt. Kur themi të gjithë, nënkuptojmë të gjithë njerëzit anë e mbanë botës. Duam të kemi një jetë të qetë dhe paqësore. Duam që zëri ynë të mos mbetet i padëgjuar. Gjithashtu, duam të jemi pjesë e vendimmarrjes. Lajmi i mirë është se të gjitha këto i kemi në demokraci. Ne si qytetarë e mbajmë kurorën. Jemi të lirë që vetë t'i zgjedhim personat, të cilët do ta udhëheqin vendin tonë. Këtë e bëjmë, duke ua besuar atyre votat tona.

Ndihemi të sigurt, sepse kemi ligjet që na mbrojnë dhe na rregullojnë jetën. Nëse nuk do t'i kishim këto ligje, jeta jonë do të ishte shumë kaotike. Kjo është një lloj sikurse të luash një aktivitet apo një lojë, pa pasur rregulla. Sigurisht se kjo nuk do të mund të ndodhë. Por, nëse nuk mund të luajmë një lojë pa rregulla, a mund të jetojmë në një shtet pa rregulla? Medoemos që kjo pyetje ka përgjigje negative.

E mira e gjithë kësaj është se ne vetë i zgjedhim personat, të cilët miratojnë ligje për të mirën tonë. Këta persona janë përfaqësuesit tanë. Ndryshe ne i quajmë deputetë. Ata punojnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pra, një ndër funksionet e Kuvendit është funksioni legjislativ, që nënkupton miratimin ose mos miratimin e ligjeve. Funksioni tjetër është funksioni kontrollues, sepse kontrollon punën e Qeverisë. Si

dhe funksioni përfaqësues, sepse qytetarët përfaqësohen nga deputetët. Kuvendi përbëhet nga 120 deputetë. Gjithçka që ndodh aty prek jetën tonë. Nëse në të ardhmen, dikush nga klasa jonë vendos të bëhet shkrimtar, puna e tij mbrohet me ligj. Kjo sepse askush nuk ka të drejtë të marrë shkrimet e tij, pa e cituar më parë atë. Nëse kjo ndodh, atëherë konsiderohet plagjiaturë, e cila dënohet me ligj. Ka edhe mënyra të tjera se si ligji na mbron. Nëse duhani konsumohet në hapësira të mbyllura, kjo vepër është shkelje e ligjit. E, në vendin tonë ekziston ligji që ndalon pirjen e duhanit në hapësirat e mbyllura. E gjitha kjo për ta mbrojtur shëndetin tonë.

Pra, rëndësia e Kuvendit është jashtëzakonisht e madhe. Prandaj, deputetët duhet të zgjedhen me shumë kujdes nga ne.



Autorët e artikullit gjatë punës në grup

NDARJA E PUSHTETIT NË KOSOVË

JON (13), LION (13), ERBLIN (12), ARIOLA (12), DEA (13), ELTINA (12)



Ne sot gjatë punës tonë si gazetarë, mësuam për ndarjen e pushtetit. Artikulli në vazhdim përmban informata pikërisht për këtë temë

Do të fillojmë duke iu treguar sesi zgjedhim kryetarin e klasës sonë. Ky proces zhvillohet në bazë të shumicës së votave tona, sikurse populli që zgjedh deputetët e Kuvendit të Kosovës. Të gjithë nxënësit e klasës janë kandidatë për kryetar të klasës. Mirëpo, ka edhe pozita të tjera, si: sekretari dhe arkatari i klasës. Kandidati për kryetar të klasës duhet të jetë i drejtë, i



zgjuar, i sjellshëm dhe të ketë nota të mira. Këtë vit shkollor ne kemi si kryetare të klasës, Blertinën. Meqë Andi ka marrë më pak vota sesa Blertina, ai është sekretari i klasës. Kurse, arkatare e kemi Mjellmën. Kryetarja e klasës ka për detyrë të kujdeset për klasën, të lajmëroj parregullsitë që ndodhin, të përfaqësojë klasën tonë në mbledhjet e klasave të të gjithë shkollës, etj. Ajo, po ashtu, bisedon me neve për problemet që i kemi. Sekretari i klasës në anën tjetër,

zëvendëson dhe ndihmon kryetaren e klasës. Në fund, arkatarja e klasës ka përgjegjësi që të mbledh të hollat e fondit të klasës dhe kujdeset për blerjet e klasës. Këta tre persona kanë detyra dhe përgjegjësi të ndara, sikur institucionet e vendit tonë demokratik.

Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, të cilët kanë për detyrë të miratojnë ligjet tona. Pikërisht për këtë arsye, ky institucion mban Pushtetin Legjislativ, sepse nxjerr ligje. Ndërsa, pasi këto ligje nxirren, ato duhet të dërgohen tek Qeveria, e cila ekzekuton ligjet me ministrinë e saj. Prandaj, Qeveria njihet ndryshe si Pushteti Ekzekutiv. Mirëpo, nëse njëri prej nesh shkel ligjet, atëherë ka të drejtë të gjykohej nga gjykata për veprën e bërë, përmes provave dhe dëshmimeve. Gjykatat paraqesin Pushtetin Gjyqësor. Të gjitha këto institucione punojnë për popullin. Andaj, ato nuk duhet të abuzojnë me pushtetin e tyre. Ne, falenderojmë „Demos-ti“ për këtë mundësi dhe shpresojmë që edhe fëmijët e tjerë do ta kenë të njëjtën mundësi që patëm ne sot.



Fotografia e gazetarëve

VOTA, E DREJTA THEMELORE DEMOKRATIKE

BLERTINA (13), MJELMA (12), LEONA (13), MUHAMED (13), ENIS (13), ARDI (13)



Zgjedhjet dhe votimi si e drejtë themelore demokratike, si dhe rëndësia e pjesëmarrjes së qytetarëve në këtë proces. Për të gjitha këto, do të informoheni në artikullin tonë. Andaj, ju ftojmë ta lexoni

Zgjedhjet janë një ndër proceset më të rëndësishme që zhvillohen në vendet me sistem demokratik. Përmes tyre, qytetarët mbi moshën 18 vjeçare realizojnë një ndër shumë të drejtat që ata kanë. Ani pse, vota nuk është obligative, ne si qytetarë ndihemi të përgjegjshëm ndaj këtij veprimi. Me anë të votës ne vendosim për të ardhmen tonë si qytetarë. Por, po ashtu, vendosim edhe për të ardhmen e vendit tonë. Të drejtën për të marrë pjesë në procesin e votimit e gëzon çdo qytetar pa dallim gjinie, feje, race, apo kombësie. Rëndësia e zgjedhjeve është shumë e madhe. Ne si qytetarë në një farë mënyre jemi pjesë e vendimmarrjes. Si është e mundur kjo, mund të pyet dikush nga lexuesit tanë? Kjo ndodh pasi që ne i zgjedhim përfaqësuesit tanë. Këta përfaqësues marrin vendime që pa dyshim janë jo veç në të mirën tonë, por në të mirën e tërë popullit. Ashtu siç e dijmë, vendi ynë është mirë atëherë kur të gjithë ne jemi mirë, e jo kur qytetarë të caktuar janë mirë. E kjo arrihet përmes procesit të zgjedhor. Qytetarët, të cilët janë të moshës 18 vjeçare, marrin pjesë në dy lloje të zgjedhjeve. Në zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Në zgjedhjet lokale, ata votojnë për asamblenë komunale, ku hyn edhe kryetari i komunës së tyre. Pra, qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e tyre komunal dhe kurdo që kanë nevojë për ndryshim në komunën e tyre i drejtohen kësaj asambleje. Për shembull, fshati ynë, Pozhorani, ka nevojë për si-


gurimin e qytetarëve nga kafshimi i qenve endacakë. Për këtë, familjarët tanë kanë paraqitur një kërkesë në Komunën e Vitisë, sepse çdo ditë ne ndihemi të rrezikuar. E probleme si këto që prekin komunën, duhet të drejtohen tek Asambleja jonë Komunale. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore qytetarët votojnë për deputetët. Deputetët mund të jenë pjesë e ndonjë partie politike, por mund të jenë edhe të pavarur. Pasi i përmendëm partitë, mendojmë që është e drejtë t'iu tregojmë se çfarë janë partitë politike. Meqë vendi ynë ka afër 2 milionë banorë, pa diskutim që në mesin e tyre ka nevoja dhe kërkesa të ndryshme. Për këtë kemi edhe parti të ndryshme. Partitë politike janë grupe njerëzish, të cilët kanë mendime përafërsisht të njëjta rreth çështjeve të ndryshme.




Autorët e artikullit të zgjedhjeve

Këtu mund të lexoni më shumë për zgjedhjet qendrore në Republikën e Kosovës dhe votuesit e Kosovës


Pra, partitë politike i votojmë në zgjedhjet qendrore. Si shembull konkret, kemi zgjedhjet që u mbajtën javën e kaluar. Qytetarët nga të gjitha komunat e Kosovës përmes votës shprehën vullnetin dhe dëshirat e tyre. Ata zgjedhën se kush do t'i përfaqësojë interesat dhe nevojat e tyre për katër vjet. Kjo është një ndër arsyt kryesore pse qytetarët duhet të marrin pjesë në procesin zgjedhor. Në rast se ndonjëri nga qytetarët nuk merr pjesë në procesin zgjedhor, atëherë ai/ajo nuk ka të drejtë të kërkojë asgjë nga të zgjedhurit. Nuk mund të kërkojë llogari nga deputetët, nëse ti si qytetar/e nuk ke qenë pjesë e procesit zgjedhor. Kjo është pra, arsyeja pse duhet të gjithë të jemi pjesë e vendimmarrjes së vendit tonë. Së bashku ne kemi qëllim që të ndërtojmë një demokraci të mirë. Jo duke e kritikuar njëri-tjetrin, por duke u përmirësuar së bashku.




Disa fakte të shkruara nga ne



Deputetët janë si ombrella. Na mbrojnë dhe punojnë për ne



Zgjedhjet janë çdo ditë në mesin tonë



Vota e të gjithëve ndikon në të ardhmen e vendit



Grupi gjatë punës



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Halil Alidema“
Klasa: VII-3
Vendi: Pozhoran, Viti